



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 89

31 korrik

2012

**AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 25.7.2012**

**PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR MARRJEN E MASAVE TË MENJËHERSHME NDAJ
SUBJEKTEVE QË GJENEROJNË ZHURMË TEJ NORMAVE TË LEJUARA NË QENDRAT
URBANE DHE ZONAT TURISTIKE E BREGDETARE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli I Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Krijimin e task-forcës në nivel qarku për marrjen e masave të menjëhershme për përballimin e situatës së krijuar nga ushtrimi i aktiviteteve ekonomike, që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane, zonat turistike dhe bregdetare.

Neni 2

1. Task-forca drejtohet nga prefekti i qarkut përkatës dhe ka në përbërje:
- a) kryetarin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit në nivel qarku;
 - b) inspektorë të njësive inspektuese të Inspektoratit të Mjedisit në nivel qarku;
 - c) punonjës të shërbimeve të Policisë së Shtetit;
 - ç) inspektorë të policisë së bashkisë ose komunës, sipas juridikisonit territorial përkatës;
 - d) specialistë të Institutit të Shëndetit Publik dhe të strukturave vendore të shëndetit publik;
 - dh) përfaqësues të prefektit të qarkut;

- e) inspektorë të Inspektoratit Shtetëror të Punës në nivel qarku.
2. Punonjësit e task-forcës zbatojnë detyrimet e caktuara nga legjislacioni i posaçëm dhe ky akt normativ.

Neni 3

1. Task-forca ushtron aktivitetin e saj në çdo ditë të javës, duke ndaluar ushtrimin pas orarit të lejuar të veprimtarive të subjekteve, fizike e juridike, të cilat janë burim zhurme, si dhe në rastet e njoftimit nga institucionet shtetërore apo komuniteti për tejkalim të normave të lejuara të nivelit të zhurmës në mjedis.
2. Për mjediset e hapura, orari i lejimit të veprimtarive për ditët e premte dhe të shtunë të jetë nga ora 19:00 deri në orën 24:00, ndërsa për ditët e tjera të javës të jetë nga ora 19:00 deri në orën 23:30, sipas normave të lejuara të zhurmës, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".
3. Për mjediset e mbyllura, veprimtaria lejohet duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, të përcaktuar në udhëzimin e përmendur në pikën 2 të këtij neni.

Neni 4

1. Strukturat e Policisë së Shtetit, si pjesë e task-forcës, mbështetin ushtrimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Mjedisit për ekzekutimin e vendimeve, për të cilat ligji i posaçëm parashikon dënime administrative plotësuese, pezullim të aktivitetit dhe sekuestrim të pajisjeve dhe impianteve të subjekteve, që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", dhe aktet ligjore në fuqi.
2. Në rastet kur subjektet kundërshtojnë ndërprerjen e aktivitetit, ekzekutimin e vendimeve të Inspektoratit të Mjedisit referuar pikës 1 të këtij neni, ose pengojnë kryerjen e matjes së zhurmës nga specialistët e Institutit të Shëndetit Publik, veprohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", si dhe për rastet kur veprimet e subjekteve përbëjnë vepër penale, materialet i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor.

Neni 5

Njësitë e inspektimit të Inspektoratit të Mjedisit në qarqe, strukturat ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore, strukturat vendore të shëndetit publik dhe Institutit të Shëndetit Publik, si dhe strukturat e Policisë së Shtetit, marrin masa të menjëhershme për zbatimin e kërkesave ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë akt normativ, duke bashkëpunuar dhe duke bashkërenduar punën për garantimin e qetësisë publike në këto zona.

Neni 6

Ngarkohen strukturat e Inspektoratit të Mjedisit, të Institutit të Shëndetit Publik, strukturat vendore të shëndetit publik, njësitë e qeverisjes vendore, prefektet e qarqeve dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 7

Moskryerja e detyrës së ngarkuar nga punonjësit e strukturave të përcaktuar në nenin 2 të aktit normativ, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe përbën shkak për fillimin e procedurave të largimit nga detyra.

Neni 8

Pika 3.1. e vendimit nr.587, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike", shfuqizohet.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha